



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.41

19 mars

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.253, datë 27.2.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bulgarec, të qarkut të Korçës	1821
Vendim i KM nr.254, datë 27.2.2008	Për hapjen e programeve të tjera studimi pranë shkollës së lartë universitare private “Wisdom University”	1823
Vendim i KM nr.255, datë 27.2.2008	Për hapjen e programeve të tjera studimi pranë shkollës së lartë universitare private “Universiteti Europian i Tiranës”	1824
Vendim i KM nr.256, datë 27.2.2008	Për hapjen e programeve të tjera studimi pranë shkollës së lartë universitare private “University of New York -Tirana”	1825
Vendim i KM nr.257, datë 27.2.2008	Për hapjen e programit tjetër të studimit pranë shkollës së lartë universitare private “Aldent”	1825
Vendim i KM nr.258, datë 27.2.2008	Për hapjen e programeve të tjera studimi pranë shkollës së lartë universitare private “Sevasti &Parashqevi Qiriazi”	1826
Vendim i KM nr.259, datë 27.2.2008	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”	1827
Vendim i KM nr.261, datë 27.2.2008	Për trajtimin e punonjësve, që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të “Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos	1828
Vendim i KM nr.262, datë 27.2.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar	1829

Vendim i KM nr.267, datë 5.3.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i fushës së mbetjeve urbane, Peshkopi	1829
Vendim i KM nr.268, datë 5.3.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash (pjesa e tretë)	1833
Vendim i KM nr.269, datë 5.3.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i parë)	1837
Vendim i KM nr.274, datë 27.2.2008	Për lejimin e kalimit transit të disa trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	1844

VENDIM
Nr.253, datë 27.2.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA BULGAREC TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bulgarec të qarkut të Korçës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 24 (njëzet e katër), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bulgarec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR I LISTES PERFUNDIMTARE TE PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE (sipas inventarizimit te pronave te vecanta te tipit pyje, kullota, livadhe, shkembore, etj.)

Institucioni i Pushtetit Qendror: M.M.P.A.U.

Komuna: Bulgarec

Nr.	Nr. i prones sipas VKM	Emertesa e ekonomise pyjore dhe kullosore sipas (PPK) Shtrirja gjeografike PPK	Emertesa e ngastres Vendndodhja (sipas emerteses popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Siperfaqja ne ha	Funksioni per te cilen perdoret prona	Institucioni me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	124	EP Maliq Dersnik	akacie kloce	99a	Pyll	17,50	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
2	125	EP Maliq Dersnik	akacie kloce	99b	Pyll	16,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
3	126	EP Maliq Dersnik	koeila biranj	100a	Pyll	12,25	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
4	127	EP Maliq Dersnik	koeila biranj	100b	Pyll	17,25	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
5	129	EP Zemblak Qarr	kuc I zi	23	Pyll	39,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
6	130	EP Zemblak Qarr	kuc I zi	24a	Pyll	29,25	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
7	131	EP Zemblak Qarr	lendina e pazarit	24b	Pyll	15,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
8	140	EP Zemblak Qarr	prroi I runzelit	30a	Pyll	17,50	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
9	141	EP Zemblak Qarr	prroi I runzelit	30c	Pyll	6,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
10	144	EP Zemblak Qarr	runzeli I belortase	33a	Pyll	41,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
11	145	EP Zemblak Qarr	runzeli I belortase	34	Pyll	54,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
12	146	EP Zemblak Qarr	venja e nevicshtit	35a	Pyll	7,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
13	147	EP Zemblak Qarr	venja e nevicshtit	36	Pyll	48,75	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
14	159	EP Zemblak Qarr	shen marene	49a	Pyll	45,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
15	160	EP Zemblak Qarr	shen marene	50a	Pyll	34,75	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
16	161	EP Zemblak Qarr	shen marene	51	Pyll	43,25	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
17	162	EP Zemblak Qarr	prroi I dardhes	52a	Pyll	53,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
18	163	EP Zemblak Qarr	prroi I dardhes	53a	Pyll	51,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
19	164	EP Zemblak Qarr	prroi I dardhes	54a	Pyll	60,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
20	165	EP Zemblak Qarr	pyllezimi dishnice	55a	Pyll	64,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
21	166	EP Zemblak Qarr	pyllezimi dishnice	55b	Pyll	34,50	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
22	168	EP Zemblak Qarr	plaja e dishnices	57	Pyll	24,00	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
23	169	EP Zemblak Qarr	plaja e dishnices	58	Pyll	57,50	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	
24	172	EP Zemblak Qarr	plaja e barcit	59a	Pyll	60,50	Prodhues	M.M.P.A.U.	D.SH.P. Korçë	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
124 – 127; 129 – 131;	Pyje, kullota	Në pronësi
140 – 141; 144 – 147;	Pyje, kullota	Në pronësi
159 – 166; 168;	Pyje, kullota	Në pronësi
171 – 172.	Pyje, kullota	Në pronësi

VENDIM
Nr.254, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA STUDIMI PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “WISDOM UNIVERSITY”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Wisdom University”, Tiranë, për hapjen e fakultetit me programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, për:

- a) psikologji;
- b) drejtësi.

2. Kohëzgjatja e këtyre programeve do të jetë 3 vjet. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma, e nivelit të parë (DNP), në fushën e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet “Wisdom University” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. “Wisdom University” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. “Wisdom University” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.255, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA STUDIMI PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Universiteti European i Tiranës”, Tiranë, për hapjen e Fakultetit Ekonomik, me programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, për:

- a) ekonomik;
- b) financë-bankë;
- c) menaxhim biznesi;
- ç) administrim publik.

2. Kohëzgjatja e secilit program do të jetë nga 3 vjet. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), në fushën e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet “Universiteti European i Tiranës” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Universiteti European i Tiranës do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Universiteti European i Tiranës duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.256, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA STUDIMI PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “UNIVERSITY OF NEW YORK -TIRANA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “University of New York - Tirana”, Tiranë, për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë” për:

- a) administrim biznesi;
- b) administrim biznesi, me profil bankar.

2. Kohëzgjatja e këtyre programeve do të jetë nga 16 deri në 19 muaj, në plotësimin e të paktën 60 krediteve. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”.

3. Ngarkohet “University of New York - Tirana” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. “University of New York – Tirana” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. “University of New York – Tirana” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.257, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TJETËR TË STUDIMIT PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “ALDENT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Aldent”, Tiranë, për hapjen e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë, në “Stomatologji”, në formën e studimit me kohë të plotë.

2. Kohëzgjatja e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë do të jetë 5 vite. Në përfundim të programit të studimeve lëshohet diploma e integruar e nivelit të dytë (DIND), në fushën

e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Aldent” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Shkolla e lartë universitare private “Aldent” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Aldent” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.258, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA STUDIMI PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Sevasti&Parashqevi Qiriazhi”, Tiranë, për hapjen:

- në Fakultetin e Ekonomisë, të programeve të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, për:

a) administrim publik;

b) marketing;

c) turizëm;

ç) bankë dhe institucione financiare.

- në Fakultetin e Drejtësisë, të programit të studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të plotë, në fushën e së drejtës së biznesit.

2. Kohëzgjatja e programeve të studimit të ciklit të parë do të jetë 3 vite. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP) në fushën e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Sevasti&Parashqevi Qiriazhi”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Shkolla e lartë universitare private “Sevasti&Parashqevi Qiriazhi” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.259, datë 27.2.2008

PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË
“SHKOLLA E LARTË AMERIKANE E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës” do të organizohet në tri fakultete:

a) Fakulteti Mjekësor, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

i) stomatologji (5 vite akademike);

ii) infermieri (3 vite akademike);

iii) teknik laborator (3 vite akademike);

iv) fizioterapi (3 vite akademike);

v) teknik farmacist (3 vite akademike);

vi) teknik imazherie (3 vite akademike).

b) Fakulteti i Drejtësisë, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

i) drejtësi (3 vite akademike);

ii) jurist/specialist ndërmarrjeje (3 vite akademike).

c) Fakulteti i Ekonomisë, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

i) administrim biznesi (3 vite akademike);

ii) financë-bankë (3 vite akademike).

3. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, në Fakultetin Mjekësor do të ofrojë një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili do të zgjasë 5 vite, dhe në mbarim të tij do të lëshojë diplomë të integruar, të nivelit të dytë (DIND), në fushën e arsimimit të kryer, ndërsa programet e tjera të këtij fakulteti dhe të fakulteteve të tjera do të jenë programe studimi të ciklit të parë të cilat do të zgjasin 3 vite, dhe në mbarim të tyre do të lëshohet diplomë të nivelit të parë (DNP), në fushën e arsimimit të kryer.

4. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit

dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.261, datë 27.2.2008

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE, QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI
I RISTRUKTURIMIT TË “ARMO” SHA TIRANË, DHE “ALBPETROL” SHA PATOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e “Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos, që dalin të papunë, si pasojë e ristrukturimit, përveç trajtimeve, që parashikohen nga Kodi i Punës, përfitojnë, për një periudhë njëvjeçare, pagesë sipas pagës bruto mesatare mujore individuale (pagë bazë+vjetërsi), të vitit të fundit të punës. Në përfundim të kësaj periudhe, punonjësit kanë të drejtë të aplikojnë për të ardhurën nga papunësia.

2. Periudha, gjatë së cilës këta persona do të marrin pagesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, njihet periudhë sigurimi, për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, të invaliditetit dhe atij familjar, kundrejt pagesës së kontributit, në fondin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, nga “Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos. Periudha e mësipërme e pagesës të shënohet në librezën e punës.

3. Përfitojnë nga ky vendim të gjithë punonjësit aktualë të “Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos, që kanë qenë të punësuar në këto shoqëri për një periudhë jo më pak se 2 vjet pa ndërprerje, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Të drejtën e trajtimit, në përputhje me këtë vendim, e përfitojnë ata punonjës, të cilët nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit. Në rast të kundërt u ndërpritet kompensimi, që përfitojnë sipas këtij vendimi.

5. Fondi prej 376 000 000 (treqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë) lekësh, i llogaritur për 606 punonjësit që dalin të papunë nga ristrukturimi i “Armo” sh.a. dhe fondi prej 372 200 000 (treqind e shtatëdhjetë e dy milionë e dyqind mijë) lekësh, i llogaritur për 1 100 punonjësit, që dalin të papunë nga ristrukturimi i “Albpetrol” sh.a. të përballohen, përkatësisht, nga likuiditetet e këtyre shoqërive.

6. Pagesat e punonjësve të bëhen nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse.

7. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.262, datë 27.2.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.78, DATË 8.2.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË
SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 6 e vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.267, datë 5.3.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I FUSHËS SË
MBETJEVE URBANE, PESHKOPI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i fushës së mbetjeve urbane, në qytetin e Peshkopisë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Peshkopi.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 8 000 m², tokë/arë, e vlerësuar me 400 lekë/m², me vlerë shpronësimi 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 99 000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga bashkia Peshkopi.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit mars 2008.

7. Bashkia Peshkopi të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë bashkisë Peshkopi, dhe ata, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë, pranë subjektit kërkues, bashkia Peshkopi.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkia Peshkopi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I
NDËRTIMIT TË FUSHËS SË MBETJEVE URBANE, PESHKOPI

Nr.	Emri	Sipërfaqja/ tokë arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Shënime
1.	Bedri Fiqiri Shehu	3685	400	1 474 000	Plotësim dokumentacioni
2.	Baftjar Bajram Zajmi	3015	400	1 206 000	Proces regjistrimi
3.	Emin Begu	630	400	252 000	Proces regjistrimi
4.	Hashim Shehu	670	400	268 000	Proces regjistrimi
	Shuma	8000	400	3 200 000	


Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 200 000 (tre milionë e dyqind mijë) lekë.

MBETURINAVE URBANE PER QYTETIN E PESHKOPIT
 1 PERFAQA S=8000M²
 H 1"1000



LOKALIZIMI KADASTRAL
FUSHËS SË MBETURINAVE
URBANE PËR QYTETIN E PESHKOPISË
SH. 112500

K-34-77-(254-D)




"MIRATOHET"

PRYETARI I K.R.R.T. TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

/ ILIR META/

MINISTRI I BUQËSISË dhe USHQIMIT

/ LUFTER XHUNELI/



PREFEKTI I QARKUT DIBER

/ HAJREDIN TAHIRI /



VENDIM
Nr.268, datë 5.3.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH (PJESA E TRETË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash (pjesa e tretë).
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 58 570 m² tokë/arë, të vlerësuar me çmimin 650 lekë/m², me vlerë 38 070 500 (tridhjetë e tetë milionë e shtatëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, për sipërfaqen 8 859.5 m² tokë/truall, të vlerësuar me çmimin 1 500 lekë/m², me vlerë 13 289 250 (trembëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 51 359 750 (pesëdhjetë e një milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 51 359 750 (pesëdhjetë e një milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 5. Shpronësimi të fillojë më 15.3.2008 dhe të përfundojë më 15.6.2008.
 6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likuidojë pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë, që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E SHPRONESIMEVE PER SEKSIONIN "ZALL XHUXH-THIRRE"

Nr.	NR.ZK	NR.PASU	SIP. ARE(m2)	CMIMI	VLERA LEKE	SIP.TRUAL L (M2)	CMIMI	VLERA LEKE	VLERA TOTALE	SHENIME	FSHATI
1	3883	83	50	650	32500				32500	KONFIRMIM ZRPP	ZALL-XHUXHE
